

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal

Nr 5, datë 28.04.2023

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”(Ora 10²⁰)

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|----------------------|
| 1.Gentjan Hamzaraj | 15.Rozina Kormuzi |
| 2.Jonela Halili | 16.Simo Petromilo |
| 3.Migena Balla | 17.Edlira Kapllanaj |
| 4.Pëllumb Nezha | 18.Sulltana Bilbilaj |
| 5.Edison Kapaj | 19.Jerina Dervishaj |
| 6.Kasëm Mahmuti | 20.Englantina Imeraj |
| 7.Evis Allushi | 21.Roneda Muçaj |
| 8.Mujo Shakaj | 22.Asime Feraj |
| 9.Ardian Skëndaj | 23.Arben Meksi |
| 10.Liljana Breshani | 24.Kristaq Meçi |
| 11.Brunilda Cani | 25.Frosina Qyrdeti |
| 12.Isterf Dobi | 26.Grigor Dede |
| 13.Brunilda Saliaj | 27.Lindrit Beqiraj |
| 14.Ervis Moçka | |

Mungojnë:

- 1.Alboren Aliaj
- 2.Ina Islamaj
- 3.Julian Bleta
- 4.Briseida Çakërri
- 5.Ramona Jaho
- 6.Klara Bajaziti

- 7.Elona Toçaj
- 8.Sulejmën Bubeqi
- 9.Andi Resulaj
- 10.Rudi Pashaj
- 11.Sokol Kushta
- 12.Kreshnik Tepelena
- 13.Teki Xhemalaj
- 14.Anisa Shametaj
- 15.Adiola Gjoka
- 16.Paula Sullaj
- 17.Anxhela Aliraj
- 18.Bujar Osmënaj
- 19.Fatos Rukaj
- 20.Besian Gega
- 21.Klearda Rapushi
- 22.Ervis Caushaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 5/1, datë 28.04.2023

Znj.Migena Balla – Përshëndetje të gjithëve!

Kuorumi është i plotësuar, mendoj të fillojmë mbledhjen. Fjalën e ka zonja Jonela për të na njohur me shprehjen e ligjshmërisë.

Znj.Jonela Halili – Ju bëj me dije, konfirmimin e ligjshmërisë, ardhur me dy shkresa nga institucioni i prefektit të qarkut Vlorë.Me shkresën e parë vendimet e këshillit,Nr 18÷26, datë 31.03.2023 , janë shpallur të ligjshëm dhe, me shkresën e dytë ,vendimet Nr 27÷ 32,datë 31.03.2023 nga institucioni i prefektit të qarkut janë të ligjshëm, përveç VKB Nr 29 , i cili nuk është vlerësuar i ligjshëm.

Znj.Migena Balla – Materialet i keni pas në postën elektronike.

Z.Grigor Dede – Na ka ardhur një projektvendim shtesë, që ka të bëjë me një ndryshim, mbetet i njëjti zë, kalon nga Njësia Administrative Novoselë dhe i kalohet për likuidim sipërmarrësit për skarpatën , mbas godinës së bashkisë. Diskutuar dhe me komisionin juridik. Është gjithçka në rregull, dhe baza ligjore.

Znj.Migena Balla – Hedhim në votë rendin e ditës me shtesën e propozuar nga zoti Grigor, projektvendimin, për një ndryshim në buxhet. Votohet.

Z.Ardian Skëndaj – Në lidhje me vendimin, që erdhi jo i ligjshëm, nga prefekti . Administrata ka plotësuar dokumentacionin, i ka nisur me e-mail. Pra, ta rifusim në rendin e ditës.

Z.Ervis Moçka – Sigurisht që, prefekti ka arsyet e veta për këtë projektvendim.

Znj.Migena Balla – Me kërkesë, propozim të kryetarit të grupit në lidhje me VKB Nr 29 , ta fusim në rendin e ditës.

Pra, hedhim në votë , rendin e ditës me këto dy projektvendime shtesë, pra rikonfirmimi i vendimit dhe ndryshimin në buxhet.


E hedhim në votë me këto ndryshime, rendin e ditës.

Votohet.

Pro – 27 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota. Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 5/2, datë 28.04.2023

Znj.Migena Balla - Kalojmë në pikën 1 të rendit të ditës, në miratimin e procesverbalit të mbledhjes së këshillit të bashkisë, datë 31.03.2023.

Të gjithë jemi njohur me materialin.

E hedhim në votë?

Votohet.

Pro -27 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 5/3, datë 28.04.2023

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 2 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit
“ Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë për muajin mars 2023”.
Një relacion nga administrata.

Znj.Irena Stasa - Përfitojnë ndihmë ekonomike nga të ardhurat e bashkisë 40 familje, në kushte shumë të vështira social-ekonomike, këto në njësi e rajone.
Të mos trajtohen , janë 5 familje. Dhe përfituese për herë të parë , janë 6 familje, gjithmonë nga verifikimet e bëra nga administratorët e rajoneve dhe njësite.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ?

- Jo.

E hedhim në votë.

Votohet.

Pro – 27 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 5/4, datë 28.04.2023

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 3 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin mars 2023”.

Një relacion nga zonja Irena.

Znj.Irena Stasa - Janë 14 familje përfituese nga fondet e qeverisë.

Znj.Edlira Kapllanaj - Faleminderit zonja Irena, që mbështet dhe ndihmon familjet me probleme, me dhënien e ndihmës ekonomike . Në lidhje me një qytetare që nuk është në punë dhe s’merr ndihmë ekonomike , banore në rajonin Nr 1. Shkuam tek Zyra e Punës për tu rregjistruar.

Znj.Irena Stasa – Fillimisht qytetari shkon në Zyrën e Punës, atje rregjistrohet në sistem.

Znj.Edlira Kapllanaj – Është e komunitetit egjiptian, është problemi tek Zyra e Punës. Ka probleme shëndetësore, nuk punon dot. Nuk e rregjistruan. Këto ankesa ti bëhen të ditura Zyrës së Punës .

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime në lidhje me projektvendimin ?

-Jo.

Votohet.

Pro – 27 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 5/5, datë 28.04.2023

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 4 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së znj.Tefta Selimllari në datën 26.12.2022 dhe, shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë “.

Një relacion nga administrata.

Z.Adrian Vreshtazi – Drejtorja e Mbrojtjes Civile , vjen me 2 projektvendime që, kanë të bëjnë me vlerën financiare për djegien e dy banesave të zonjës Tefta Selimllari dhe zonjës Ëngjëllushe Halili, me vlerat përkatëse. VKM Nr 329 është bazë për vazhdimin e procedurave . Kërkojmë miratimin e këtyre dy projektvendimeve për tu ardhur në ndihmë sa më parë qytetareve.

Znj.Frosina Qyrdeti – Jam dakort, por do të thoja që, nuk kemi relacion të detajuar për të dy rastet.

-Ndërsa , për zonjën Tefta, pse nuk është bërë më parë projektvendimi?

Znj.Migena Balla – Është dhe relacioni i protokolluar. Është materiali dhe në e-mail. Për pyetjen tjetër, zoti Adrian ?

Z.Adrian Vreshtazi - Relacionet janë bashkëlidhur. Drejtorja e mbrojtjes civile mund tju vijë në ndihmë, sa më shpejt, por ka procedura dhe, zonja i solli me vonesë dokumentat. Erdhi projektvendimi pasi ishte mbyllur rendi i ditës, herën e kaluar.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ?

-Jo.


Votohet.

Pro – 27 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 5/6, datë 28.04.2023

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 5 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së zonjës Ëngjëllushe Halili në datën 23.01.2023 dhe, shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.
Një relacion , zoti Adrian.

Z.Adrian Vreshtazi - Për dy projektvendimet sqarova. Dhe për zonjën Ëngjëllushe, është e njëjta procedurë.
Bazë është VKM Nr 329 .

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ?

-Jo.


Votohet.

Pro -27 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 5/7, datë 28.04.2023

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 6, pikën shtesë të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “ Për një ndryshim në VKB Nr 1, datë 18.01.2023, për buxhetin e bashkisë, për vitin 2023, i ndryshuar”.

Z.Daut Zëraj – Ky projektvendim , ka të bëjë me një detyrim të prapambetur për skarpatin, mbas bashkisë, planifikuar në buxhetin e vitit 2022, ka mbetur diferenca. Për këtë detyrim të prapambetur është paraqitur në” zë”, ku shtohet dhe ku hiqet.

Znj.Jonela Halili – Mos kemi të bëjmë vetëm me ndryshim dhe o shtesë, emërtimi...

Z.Daut Zëraj – Është vetëm ndryshim, nga ” zë” në “zë”.

Znj.Migena Balla – Pra, në zbardhje të vendimit, ndryshim dhe jo shtesë.

Znj.Jonela Halili – Pra, dhe miratimi do të jetë, vetëm për ndryshim .

Z.Kasëm Mahmuti – Së pari pika”b” të kalojë para pikës “a”. Tabelat janë këmbyer.(Lexon).....për ti dhënë një formë më të përshtatëshme....

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ?

-Jo.

Votohet.

Pro – 27 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 5/8, datë 28.04.2023

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 7 shtesë. Po lexoj një komunikim, ardhur nga zonja Sonela me e-mail, në lidhje me projektvendimin për kalimin nga përdorimi në pronësi të tokës bujqësore. (Lexon)...Dosjet janë në proces plotësim dokumentacioni nga ASHK, por kjo, nuk ndikon aspak në ligjshmërinë e këtij vendimi . Dokumentacioni është në ASHK, për çdo subjekt. Rast pas rasti bashkëlidhur praktikatat përkatëse.....

E hedhim në votë, për rikonfirmim?

Z.Daut Zëraj - Rishqyrtohet vendimi i ardhur nga prefekti. Pra, që , ky vendim i këshillit , mos të kalojë ashtu siç ishte , këshilli të dalë me një relacion që, u shqyrtua nga këshilli dhe u konfirmua. Të marrë përgjigje , pyetja e prefektit.

Znj.Jonela Halili –(Lexon shprehjen e ligjshmërisë), në lidhje me VKB Nr 29 datë 31.03.2023 nuk vlerësohet i ligjshëm.Vendimmarrja e këtij vendimi, parashikon kalimin në pronësi të tokës bujqësore, sipas listës emërore , ndërkohë që gjendet vetëm një praktikë.Vetëm praktika e zotit Murat Hasanaj...Pra, kur të plotësohen të gjitha praktikatat ...

Znj.Migena Balla – Për rikonfirmim, zoti Ervis, ta shohë nga ana juridike dhe bëjmë një relacion.

Z.Ervis Moçka – ASHK-ja, përcakton listën, ja dërgon këshillit të bashkisë të miratojë listën. E miratuam. Prefekti pretendon që, sipas listës , nuk është i gjithë dokumentacioni plotësues për 12 praktikatat. Ka ardhur dosja me 12 aplikime, ka ardhur nga ASHK numri i pronës, nga 1 ÷ 12. Pra, listat janë, relacioni nga ASHK-ja , planvednosjet. Këto janë 3 pikat , pra këtu konfirmohet vendimi. Ti'a përcjellim dosjet prefektit .

Znj.Migena Balla – Pra, konfirmojmë vendimin .

Votohet.

Pro – 27 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Këto ishin pikat e rendit të ditës.

Kalojmë tek pika, të ndryshme. Nëqoftëse, ka dikush për të diskutuar ?
Nëse nuk ka gjë, ju uroj ditë të mbarë . Faleminderit.